VENDIM
Nr.177, datë 25.5.1990

PËR DISA NDRYSHIME NË KOMPETENCAT E ORGANEVE SHTETËRORE DHE EKONOMIKE NË FUSHËN E FINANCAVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministave nr.416, datë 12.12.1976 "Për disa kompetenca të organeve shtetërore dhe ekonomike në fushën e organizimit, të drejtimit dhe të zhvillimit të ekonomisë popullore", bëhen këto ndryshime:

1. Kreu I, shkronja B:

- Në pikën 1, paragrafi i parë ndyshohet si vijon:

"Masa e vleftave të plota të veprave të jetë:

Për ministritë e institucionet e tjera qendrore deri në 1,5 milionë lekë.

Pë komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve:

- Kategoria e parë deri në 0.6 milionë lekë.
- Kategoria e dytë deri në 0.4 milionë lekë.

Për ndërmarrjet ekonomike dhe njësitë e bashkuara ushtarake deri në 0.2 milionë lekë".

- Pika 4 shfuqziohet.

2. Kreu II "Në fushën e financave":

- Pas pikës 1/a shtohet pika 1/b me këtë përmbajtje:

"Komiteti ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve kanë të drejtë të përdorin 30 për qind të shumës së tejkalimit vjetor të të ardhurave të buxhetit të shtetit, kur ky vjen si pasojë e masave të marra për plotësimin e tejkalimin e planit si pasojë e masave të marra për plotësimin e tejkalimin e planit të treguesve ekonomiko-financiarë nga ndërmarrjet, kooperativat bujqësore e institucionet që veprojnë në juridiksionin e rrethit.

Kjo shumë kalon në shtim të fondit rezervë të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve në buxhetin e vitit pasardhës dhe përdoret sipas kriterteve të caktuara.

Për rastet kur të ardhurat e buxhetit mbi realizohen gjatë procesit të zbatimit të buxhetit, komiteti ekzekutivi i këshillit popullor të rrethit merr masa për kufizimin e kryerjes së shpenzimeve të tij dhe kur shumat nuk balancohen, nuk ka të drejtë të krijojë fondin rezervë në buxhetin e vitit pasardhës".

- Pikat 2, 3 dhe 4 të këtij kreu shfuqizohen.

- Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"Fondi i ndihmës së përkohshme financiare për ndërmarrjet, i krijuar nga ministritë e institucionet e tjera qendrore dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve në marrëveshje me Ministrinë e Financave, të derdhet në gjendjen e arkës së buxhetit të shtetit dhe të përdoret nga Banka e Shtetit Shqiptar si burim kreditimi".

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.1991.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI